



Data: 11.04.2017

Ref.: 217/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 49-të, të mbajtur më 07 prill 2017, mori:

V E N D I M

- I. REFUZOHET kërkesa nr. 135/17, date 20.03.2017e BPrAL Kolegji "Iliria" për ri/akreditim të programit të studimit: Inxhinieri Softuerike, MSc (120 ECTS), dhe Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, MA (120 ECTS).
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

BPrAL Kolegji "Iliria" ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për akreditim të programit të studimit: Inxhinieri Softuerike, MSc (120 ECTS), dhe Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, MA (120 ECTS).

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur me 07 prill 2017 ka vlerësuar aplikacionin e Kolegjit "Iliria", dhe pas shqyrtimit të dosjeve të stafit akademik duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (nr.20/2016, datë 20.09.2016), neni 11, pika 3.2, ku sipas kësaj pike, institucioni duhet të ketë të paktën tre PhD (Dr.sc.) në marrëdhënie të rregullt pune për secilin program studimi, dhe në pajtim me nenin 13, pika 1.1 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim nr.20/2016, datë 20.09.2016, KSHC ka konstatuar që ky aplikacion nuk i përmbush kushtet për aprovim, dhe më këtë rast ka refuzuar aprovimin e aplikacionit të Kolegjit "Iliria" për programet e cekura në dispozitiv.

Kolegji "Iliria" si bartës të programit të studimit Inxhinieri Softuerike, MSc (120 ECTS) ka vendosur: Azir Aliu, Artan Luma, dhe Halil Snopçe. Bazuar në faktin se asnjëri nga personat e cekur më lartë nuk ka sjellë dëshmi se në vendin e tyre të origjinës ata nuk kanë marrëdhënie të rregullt të punës, KSHC vendosi që të refuzoj kërkesën e Kolegjit Iliria për këtë program të studimit.


Kolegji "Iliria" si bartës të programit të studimit Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, MA (120 ECTS) ka paraparë që njëri nga tre bartësit e programit të jetë Prof Aziz Pollozhani. Pas verifikimit të stafit akademik të prezantuar nga Kolegji Iliria si bartës të programeve është konstatuar që Prof Aziz Pollozhani ka marrëdhënie të rregullt pune në Universitetin "Nënë Tereza" në Maqedoni, në pozitën e Rektorit, dhe se i njëjti nuk mund të jetë bartës i programit të studimit. Në këtë bazë KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kërkesat e AKA-së për dokumente që duhet ti sjellin Institucionet e Arsimit të Lartë për stafin akademik janë të cekura në njoftimin e AKA-së dërguar të gjitha Institucioneve të Arsimit të Lartë në Kosovë (njoftimi i datës 15 shtator 2016). Ky njoftim është bërë duke u bazuar në nenin 7 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë (Ligji Nr. 04/L-037, datë 29 gusht 2011), ku sipas këtij neni, AKA shpall politikat, kriteret dhe standardet e saj për akreditim si dhe vendimet, rekomandimet dhe këshillimet për sa u përket institucioneve dhe programeve të veçanta dhe publikon një raport vjetor.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet këtij organi në afatin prej 30 ditëve siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegji "Iliria";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

